




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



## E K S T R A K T

**i procesverbalit të Konsultimit Publik për Draftregulloren për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhën më pak se një (1) vit, mbajtur më 21.06.2023, duke filluar nga ora 15:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Osman Bllaca-Kryesues, Përparim Rama-Kryetar, Doruntinë Maloku- drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës.

**Të pranishëm ishin edhe qytetarët:** Fisnik Vejsa, Merkur Krasniqi, Bujar Osmanaj, Donika Ahmetaj, Granit Hashani, Arbër Krasniqi dhe Sabedin Hasani.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Osman Bllaca.

**Osman Bllaca**, kryesues përshëndeti të pranishmit në Diskutimin Publik për draftregulloren për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhën më pak se një (1) vit. Ai tha se ky diskutim publik është edhe në platformën e diskutimeve publike i cili do të jetë deri më datën 15 korrik në ora 16:00, ku mund t'jë dërgohen edhe sugjerimet në formë të shkruar tek emaili zyrtar. Fjalën për përmbajtjen e draftit në pika të shkurta ia dha drejtoreshës së Pronës, Doruntinë Maloku.

**Doruntinë Maloku**, drejtoreshë përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe filloi me prezantimin e draftregulloreve për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit. Ajo tha se si Drejtoreshë e Pronës e kanë obligim që ta iniciojnë procedurën për miratimin e kësaj Rregulloreje meqenëse prej miratimit të ligjit 06-L-092 në vitin 2019, Komuna e Prishtinës nuk ka pasur një Rregullore e cila i përcakton procedurat dhe format se si mund të jepet prona komunale në shfrytëzim për periudhën më pak se një vit.

Kjo Rregullore në përmbajtje nuk është e gjatë dhe Komisioni ka përcaktuar procedurat e shpejta se si mund qytetarët të aplikojnë për marrje në shfrytëzim të pronës komunale në periudhën më pak se 1 vit, që natyrisht nuk ka kufizime se a mund të jepet për 1 ditë apo për 364 ditë, d.m.th i përcakton të gjitha procedurat çka janë për më pak se 1 vit.

**Neni 4** i përkufizon shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, **neni 5** i përcakton parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të cilat janë të përcaktuara qartë me ligjin të cilin e ceka më herët dhe po ashtu Rregulloren e Qeverisë të vitit 2020 e cila ka derivuar nga ligji 06-L-092, **neni 6** përcakton se në cilat raste mund ti japim në shfrytëzim pronën

komunale për më pak se një vit që janë: hapësirat publike që nënkupton, parqet, sheshet, bulevardet, fushat sportive dhe të ngjashme, shtëpitë e kulturën, kinematë, teatrot, hapësirat publike para lokaleve, lokalet dhe banesat në pronësi të Komunës, **neni 7**, kriteret e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës jepet duke u bazuar në kriteret vijuese, të jetë regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastral dhe natyrisht këtë secili qytetarë mund ta verifikojë lehtë në faqen zyrtare "Prishtina Online" sepse Drejtoria e Pronës çdo vit publikon listën e përgjithshme të pronave komunale që ka filluar për herë të parë me qeverisjen e Kryetarit Rama, kriteri tjetër është që prona të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta , kjo për shkak se kemi shumë prona të cilat janë në konteste gjyqësore dhe prandaj e kemi vendosur edhe këtë kriter: të mos ketë masë sigurie nga gjykata kompetente, të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore, të ketë arsyeshmërinë e interesit publik ose rritjes së vlerës së pronës, të ndikojë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik në Komunë.

**Neni.8** përcakton procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën për më pak se një vit, ku kërkesa i drejtohet Drejtorisë së Pronës ose një komisioni të themeluar nga kryetari i kryeqytetit. Kushtet për aplikim janë: personat fizik dhe juridik në rastin e aplikimit për marrje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, kërkesës duhet t'ia bashkëngjisin dokumentet, siç janë: formularin e plotësuar, kopjen e letërnjoftimit për personat fizik, certifikatën e regjistrimit të biznesit për persona juridik, projektin ideor në kopje fizike dhe elektronike, vërtetimin për përmbushjen e obligimit të tatimit në pronë dhe taksave komunale.

**Neni.10** pastaj tregon për shqyrtimin e kërkesave, Drejtoria e Pronës ose komisioni të cilin e sqarova më herët i themeluar nga kryetari ka për obligim që brenda afatit për 15 ditësh ta bëjë shqyrtimin e kërkesave dhe konstatimin e gjendjes faktike , **neni. 11** parasheh parashtrimin dhe zgjidhjen e ankesave, ku ankesat parashtrihen në afat prej 5 ditë pune pas njoftimit të vendimit dhe i drejtohet Komisionit të Ankesave të Komunës.

**Në nenin. 12** është paraparë dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile, ku janë përcaktuar mënyrat se si mund të marrin organizatat e shoqërisë civile pronën publike në shfrytëzim për më pak se 1vit.

**Neni.13** flet për kontratën e cila duhet të nënshkruhet në mes të kryetarit të kryeqytetit dhe palës e cila sipas Drejtorisë së Pronës ose komisionit të themeluar nga kryetari është vlerësuar ose i plotëson kushtet dhe kriteret e kësaj Rregulloreje.

**Neni.14** thotë "personi fizik apo juridik i cili nuk i përmbahet dispozitave të nenit.12 të kësaj Rregulloreje i shkëputet kontrata, në momentin që ndryshon qëllimi i dhënies në shfrytëzim atëherë komuna gjithmonë do të mbajë të drejtën që t'ia shkëpusë kontratën.

**Osman Bllaca, kryesues** hapi debatin lidhur me Rregulloren duke ia dhënë fjalën qytetarëve.

**Fisnik Vejsa**, qytetar tha se bashkë me Bujarin partnerin e tij kanë ndërtuar qe 2 vite një brend të detalizuar të një brunch të veçantë të Fast-foodit që quhet "Hotdog and Sweets" dhe kanë kërkuar të shfrytëzojnë një hapësirë publike të Komunës në dy forma: fikse dhe mobile, përmes një kërkesë të bërë me 5 prill por kërkesat janë në vakum për shkak të kësaj Rregulloreje. Hapësirën që e kanë kërkuar ka qenë 50-60 metra katror, lokacioni është parkingu te "Route66" dhe e kemi sjellë një far plani kreativ se si do të transformohet ajo pjesë në një park të gjelbër.

Për pika mobile kanë kërkuar disa pika: te sheshi, te KEK-u, tek fillimi i rrugës së “kafeve të rakisë” përballë “Euro-Sigu”. Ai tha se ka pasur takim me Erion Veliaj, i cili ka insistuar që këtë brend ta dërgojnë në Tiranë, por z. Vejsa fillimisht dëshiron ta shtrij aktivitetin e tij në Prishtinë. Brenga e tyre është pritja që 4-5 muaj, për shkak të Rregullores dhe presin bashkëpunim me Komunën në këtë drejtim.

**Doruntinë Maloku**, drejtore u përgjigj se nuk kanë mundur ti trajtojnë kërkesat që kanë ardhë për dhënie në shfrytëzim për afate të shkurta por i kanë informuar të gjitha palët për procesin e kësaj Rregulloreje.

**Fisnik Vejsa**, pyeti se a duhet të riaplikojnë sërish, apo do të merren parasysht aplikimet e tyre.

**Doruntinë Maloku**, drejtore tha se nëse ju e keni marrë një përgjigje, një informatë lidhur me procesin e Rregullores atëherë palët obligohen që sërish d.m.th me miratimin e Rregullores, të dërgojnë një kërkesë të re por nëse nuk e keni marrë përgjigjen në kërkesë, atëherë kërkesa juaj mbetet valide nëse Rregullorja miratohet nga Kuvendi Komunal.

Ligji për dhënie në shfrytëzim i parasheh 3 lloje të procedurave: e para është që ne e vendosim pronën në listë, pastaj kuvendi komunal e formon një komision dhe hapet ankandi për marrjen e pronës në shfrytëzim.

E dyta është dhënia në shfrytëzim për periudhë afatgjatë, dhe e treta me kërkesë të investitorëve të mëdhenj të cilët zotohen se do të investojnë minimumi 10% të investimeve kapitale të vitit paraprak dhe kështu e fitojnë të drejtën e negocimit direkt me kryetarin e kryeqytetit për marrjen e pronës në shfrytëzim me negocim direkt.

**Fisnik Vejsa**, tha se objekti është ndërtuar në parametrat ekologjik, kurse mobil është një foodtruck shumë atraktiv, që mund ta përdorim në pika të ndryshme.

**Doruntinë Maloku**, drejtore tha se ata mund ta zhvillojnë aktivitetin mobil, nëse i plotësojnë kriteret e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Fisnik Vejsa**, tha se fillimisht do të fillojnë me një pikë pastaj në çdo dy muaj duke e shtuar nga një, njëherë në Prishtinë për fillim dy pika mandej në Tiranë.

**Merkur Krasniqi**, tha se e shfrytëzon një pronë komunale prej 2002-tës, në kohën e UNMIK-ut kur e ka pas me Fushë Kosovë, pastaj ka kaluar me qira dhe me pagesa në Komunën e Prishtinës, që sa kohë paguajnë tatim në pronë por kontratë edhe taksën komunale nuk e paguajnë. Ai tha se i mbajnë 25 familje dhe 3-5 nxënës çdo vit e bëjnë praktikën aty dhe se shpreson që të zgjidhjet kjo çështje sa më shpejtë.

**Doruntinë Maloku**, drejtore tha se e kupton shqetësimin e parafolësit sidomos pas themelimit të një komisioni nga Kryetari i Kryeqytetit për analizën e gjendjes në Zonën Industriale, ku është rekomanduar që bizneseve në Zonën Industriale me ju dhënë një afat prej një viti, për tu transferuar në zonën ekonomike sepse iu kanë skaduar kontratat të gjithëve. Ajo rikujtoj se nuk mjafton vetëm pagesa e tatimit në pronë por është dashur të lidhet kontrata valide mes tyre dhe Komunës, pasi që shfrytëzimi i pronës deri tani është e paligjshme, pa kontratë.

**Merkur Krasniqi**, deklaroi se nuk janë ata fajtor që s'kanë kontrata dhe se nuk është mirë me hy me një thes me ata që s'kanë paguar.

**Doruntinë Maloku**, drejtore tha se kjo ka ndodhur për shkak të mosveprimit të Komunës, pasi që shumica nga operuesit në Zonën Industriale kanë pasur kontrata por pastaj nuk janë vazhduar dhe kemi ardhur në këtë situatë.

**Merkur Krasniqi**, tha se është prej të parëve që ka pas kontratë me Komunën e Fushë Kosovës dhe kemi kaluar në Prishtinë për shkak se ka qenë pronë e Komunës së Prishtinës, e Komuna nuk e ka vazhduar atë proces.

**Doruntinë Maloku**, drejtore tha se mund të shkojnë për tu konsultuar për procedurat dhe për çdo gjë, të enjten nga ora 9:00 deri në orën 12:00.

**Sabedin Hasani**, pyeti për disa OJQ, që aktivitetin e tyre e bëjnë edhe duke zhvilluar biznes, p.sh kemi grupet sportive, fëmijët paguajnë aty që e zhvillojnë aktivitetin si do të bëhet me ta? Nën dy tha se a parashihet p.sh shfrytëzuesi paraprak, a parashihet ndonjë poentim të këtë kur del në ankand, apo do të jetë i barabartë me të gjithë të tjerët, në hapësirën e vendbanimeve ku ka banesa kolektive lëshohet një pronë me qira, ai investim qiradhënia, a do të kthehet në atë lagje investimi dhe a do të këtë ndonjë përparësi ajo lagje në të hyra të asaj qiradhënie, çfarë definicione do të këtë ajo lagje.

**Doruntinë Maloku**, drejtore u përgjigj se duhet të i përmbush disa kriteret për ta marr në shfrytëzim Pronën Komunale, nëse e merr natyrisht trajtohet si biznes, nëse e merr si OJQ, si aktivitet Panair, ose s'po di çka me thanë lloj-lloj aktivitete që organizojnë sensibilizuese organizatat e shoqërisë civile atëherë kjo rregullore e ka paraparë që periudha për me pak së shtatë ditë do të trajtohet pa kompensim. Sa i përket asaj se a mundë të kthehet investimi në lagje, nëse jepet një hapësirë publike në shfrytëzim në afërsi të banesave ajo tha se kjo Rregullore nuk e ka përcaktuar një gjë të tillë, por gjatë punës dhe aktivitetit mundë të shihen nevojat e qytetareve dhe të trajtohet ajo çështje. Tjetra ishte a ka prioritet personi i cili e merr për here të pare pronën komunale në shfrytëzim, pastaj a do të këtë prioritet në përzgjedhje për herën e dytë, ligji nuk e përcakton një gjë të tillë, për shkak së procedurat për afat më të gjatë përcaktohen me Rregulloren e Qeverisë, kjo Rregullore vlen maksimumi 364 ditë dhe pas 364 ditë, nuk do të thotë që dikush trajtohet me prioritet ose diskriminohet në anën tjetër për marrjen e kësaj prone ndërsa një qytetar dëshiron që ta marr për afat me të gjatë atëherë duhet me i ndjek procedurat e ligjit që u përmendën më herët. Ajo tha se Rregullorja nuk e përcakton që ju nuk mundë ta merreni edhe vitin e dytë nuk e ndalon mirëpo nëse dikush dëshiron me e marr për dhjetë vjet, kalon në procedura tjera.

**Osman Bllaca**, kryesues tha se Rregullorja do të jete edhe 22 ditë në diskutim publik, deri me datën 15 korrik, kjo është vetëm një draft me të cilin do të plotësojmë dhe begatojmë edhe gjatë diskutimit publik gjithashtu edhe ne filtra tjerë të cilët janë prej Komunës dhe prej Komisionit për hartimin e kësaj Rregulloreje. Ai mbylli takimin duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrjen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Diskutim publik, lidhur me “Draft rregulloren për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se 1 (një) vit”

21 Qershor, 2023

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	MERKUR	KLA SRIJ-			
2	BURAR	OSMANAG			
3	FISNIK	VEJSA			
4	SADUCLIN	Hasani			
5	Donika	Ahmetaj			
6	Granit	Hashani			
7	Arbër	Krasniqi			
8					
9					
10					

P.S \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!\*